

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MonoTop®-100 Fire Resistant

LLAÇ ZJARRDURUES (ISH SIKA MONOTOP®-100 FIREBLOCK)

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Llaç zjarrdurues me mpiksje të shpejtë për vendosjen e tullave zjarrduruese si dhe për ndërtimin dhe riparimin e elementeve me rezistencë ndaj nxehtësisë.

PËRDORIMET

- Ndërtim dhe riparim të elementeve me rezistencë ndaj nxehtësisë (p.sh. barbekju, oxhaqe, furra, etj.)
- Posaçërisht i përshtatshëm si llaç për shtrimin e pllakave dhe tullave zjarrduruese, blloqeve prej betoni, tullave terrakota subjekt i temperaturave të larta të shërbimit
- Llaç për finiturë që mund të jetë subjekt i temperaturave të larta të shërbimit

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë termike e lartë. Deri në 750 °C
- Rezistenca fillestare të larta
- Përzierje e thjeshtë
- Aplikim i thjeshtë

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento argjili, agregate të përzgjedhura dhe aditivë	
Ambalazhi	Qese plastike 5 kg	
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri	
Jetëgjatësia	6 muaj	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +35 °C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.	
Dendësia	Llaç i thatë	~1.8 kg/l
	Llaç i freskët	~2.0 kg/l
Përmasa maksimale e kokrrizës	D _{max} : 2 mm	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	~37 MPa pas 24 orësh	(EN 196-1)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	~5 MPa pas 24 orësh	(EN 196-1)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	0.55 deri në 0.65 litra ujë për 5 kg pluhur
Konsumimi	Varet nga ashpërsia e nënshtresës dhe trashësia e shtresës së aplikuar. Sa për udhëzim 1.8 kg pluhuri për mm trashësie për m ²
Rendimenti	5 kg pluhuri prodhon afërisht 2.8 litra llaçi
Trashësia e shtresës	Min. 6 mm / Max. 20 mm
Temperatura e mjedisit	+5 °C minimum; +30 °C maximum
Temperatura e nënshtresës	+5 °C minimum; +30 °C maximum
Koha e punueshmërisë	~60 minuta në +20 °C

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa duhet të jetë plotësisht e pastër, pa pluhur, grimca të lira, kontaminues të sipërfaqes dhe materiale të cilat reduktojnë lidhjen midis llaçit dhe nënshtresës.

PËRZIERJA

Sika MonoTop®-100 Fire Resistant mund të përzihet mekanikisht ose manualisht. Hidhni sasinë e rekomanduar të ujit brenda një konteineri të përshtatshëm për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni pluhurin tek uji dhe përzieni plotësisht për të paktën 3 minuta derisa të arrihet konsistenca e kërkuar.

APLIKIMI

Sika MonoTop®-100 Fire Resistant mund të aplikohet manualisht duke përdorur një shpatull ose mallë. Lagni paraprakisht sipërfaqen me ujë të pastër përpara aplikimit. Sipërfaqja nuk duhet të thahet përpara aplikimit të llaçit zjarrdurues. Përpara aplikimit, uji i tepruar duhet të hiqet me sfungjer ose copë të pastër në mënyrë që sipërfaqja të jetë mat e errët pa shkëlqim dhe poret mbi sipërfaqe të mos përmbajnë ujë.

Tullat që do të jenë në kontakt me llaçin duhet të zhyten në ujë min. 10 minuta përpara aplikimit. Përpara aplikimit, hiqni ujin e tepruar në mënyrë që sipërfaqja të jetë mat e errët pa shkëlqim dhe poret mbi sipërfaqe të mos përmbajnë ujë. Gjatë aplikimit, ngjeshni llaçin, duke ushtruar presion të fortë mbi nënshtresë. Sipërfaqja duhet të finirohet sipas kërkesave duke përdorur mallë me sfungjer ose sfungjer të lagur, sapo llaçi ka filluar të fortësohet.

METODA E MATURIMIT

Mbroni menjëherë llaçin e freskët nga tharja e parakohshme duke përdorur një metodë të përshtatshme trajtimi, p.sh. membranë gjeotekstile lagështie, fletë plastike, etj. Pas ngurtësimit spërkasni lehtësisht me ujë.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Prisni të paktën 1 javë pas aplikimit përpara se të ekspozoni llaçin në temperaturë të lartë
- Kur aplikoni për herë të parë nxehtësi mbi llaç, shtoni temperaturën ngadalë
- Shmangni aplikimin në diell të drejtpërdrejtë dhe/ose erë të fortë
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të qëndrueshme dhe të përgatitura
- Mos shtoni ujë shtesë gjatë finiturës së sipërfaqes pasi kjo gjë do të shkaktojë çngjyrosje dhe plasaritja
- Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrirja

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika MonoTop®-100 Fire Resistant
Shkurt 2019, Botimi 02.01
020302050010000083

SikaMonoTop-100FireResistant-sq-AL-(02-2019)-2-1.pdf